

gap

rock on

KOMUNA E DRAGASHIT

2017: PROBLEMET

KRYESORE DHE

TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Kryetar i Komunës së Dragashit është Salim Jenuzi (PDK), i cili në vitin 2013 e fitoi mandatin e tretë si kryetar i komunës. Në balotazhin e mbajtur më 1 dhjetor 2013, Salim Jenuzi kishte siguruar 60% të votave kundrejt kandidatit nga LDK Fatmir Mehmeti. Pas balotazhit, PDK hyri në koalicion me partinë politike VAKAT për të bashkë-qeverisur në komunë.

Sipas sondazheve të UNDP¹, të cilat janë më gjithëpërfshirëset në nivel lokal, kënaqshmëria e qytetarëve të komunës me qeverisjen lokale ka shkuar duke rënë. Në krahasim me vitin 2012, ku shkalla e kënaqshmërisë së qytetarëve me pushtetin lokal ishte 22%, në vitin 2015 kënaqshmëria ka rënë në 14%. Raporti i UNDP-së po ashtu tregon se 58% e qytetarëve të komunës së Dragashit besojnë se komuna nuk është fare e përgjegjshme dhe nuk i merr parasysh shqetësimet e tyre.

Edhe pse Komuna e Dragashit ka një popullsi të përzier etnikisht, sipas anketës së UNDP-së, marrëdhëniet ndëretnike nuk paraqesin fare problem për këtë komunë. Ndërsa sa i përket rendit dhe sigurisë publike, Komuna e Dragashit është një ndër komunat më të qeta.

Si problem madhor për 4.4% të qytetarëve të anketuar është korrupsioni, për 6.5% të qytetarëve problemi më madhor është standardi i ulët i jetesës, kurse për 22.3% është mungesa e rritjes ekonomike. Problem tjetër i cili është

¹ UNDP Kosovo. Kosovo Mosaic 2015. Burimi: <http://bit.ly/2wkuTnr> (hapur së fundmi më 22 korrik 2017).

shqetësues për qytetarët e komunës së Dragashit është cilësia e arsimit të mesëm.

Më 2013, përmes hulumtimeve kualitative, intervistave me anëtarë të shoqërisë civile, gazetarë, anëtarë të partive politike dhe njohës të zhvillimeve lokale, Instituti GAP ka identifikuar problemet kryesore në Komunën e Dragashit.² Disa nga ato probleme ende janë prezente në këtë komunë. Në prag të zgjedhjeve lokale 2017, Instituti GAP përsëri ka identifikuar disa probleme konkrete të cilat kërkojnë vëmendjen e qeverisjes komunale. Përveç identifikimit të problemeve konkrete komunale, Instituti GAP do të monitorojë edhe premtimet e kandidatëve për kryetar/e dhe vetë qasjen e komunës në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Problemet kryesore në komunë

Gjendja jo e mirë në infrastrukturën e rrugëve

Disa nga rrugët kryesore në Komunën e Dragashit janë në gjendje jo të mirë. Në rrugën kryesore që lidh Dragashin me Prizrenin, konkretisht në aksin rrugor Trokan – Brezne, janë shfaqur gropa të shumta të cilat rrezikojnë edhe jetën e ngasësve në përpjekje për t'i evituar ato. Në mars 2017, Komuna e Dragashit kishte nënshkruar memorandum me Ministrinë e Infrastrukturës për financimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në Dragash me vlerë prej një milion euro. Nga kjo shumë, 150,000 euro janë ndarë për segmentin Trokan-Brezne por deri më tani ende nuk është investuar asgjë.³ Gropa dhe çarje të shumta ekzistojnë edhe në aksin rrugor Bellobrad - Buzes. Në një gjendje të keqe është edhe një pjesë e rrugës kryesore në lokacionin Tyrbe - Rrenc. Për më tepër, shumë rrugë të shtruara me kubëza nëpër fshatrat e komunës janë në gjendje jo të mirë. Një ndër ato rrugë që është në gjendje mjaft të keqe është ajo në fshatin Kuk. Një dukuri tjetër që ka ndikuar në dëmtimin e rrugëve në Komunën e Dragashit është prerja e asfaltit nga qytetarët për të kaluar ujin apo kanalizimin në pronat e tyre private. Në ato vende ku ka pasur prerje të asfaltit kanë mbetur pengesa në qarkullimin e lirë përkundër tentimit për t'i mbuluar prerjet. Prerja e asfaltit nuk do duhej të ndodhte pa lejen dhe prezencën e komunës.

Furnizimi jo i mirë me ujë të pijshëm

Përkundër burimeve të shumta të ujit që ndodhen në territorin kodrinor-malor të Komunës së Dragashit, banorët e kësaj komune ballafaqohen ose me mungesë të ujit të pijshëm ose kanë probleme me kualitetin e ujit të pijshëm. Me mungesë të ujit, kohëve të fundit janë ballafaquar më së shumti fshatrat e mëdha si fshati Bresanë apo Kuk. Përveç sasisë jo të mjaftueshme

² Instituti GAP. Komuna e Dragashit: problemet kryesore dhe trendet buxhetor.

Burimi: <http://bit.ly/2iHKVpj> (hapur së fundmi më 15 gusht 2017).

³ Raporti paraqet gjendjen në terren deri më 31 gusht 2017.

të ujit edhe kualiteti i ujit është mjaft i dobët. Në fshatin Kuk, uji që deri vonë ka qenë i pijshëm tani nuk përdoret për pije për shkak të papastërtisë.

Mosfunksionimi i shkollës së re

Rreth tetë vite i janë dashur Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të ndërtuar objektin e ri të shkollës së mesme në Dragash. Sipas kësaj ministrie, objekti ka qenë i gatshëm për shfrytëzim që nga muaji shtator i vitit 2016. Megjithatë, ky objekt që ka kushtuar më shumë se dy milion euro ende nuk ka filluar të përdoret dhe rrezikon të dëmtohet seriozisht. Nxënësit e kësaj komune vazhdojnë të vijnë në mësimet në objektin e vjetër të gjimnazit "Ruzhdi Berisha."

Kundërshtimi i banorëve për ndërtimin e hidrocentraleve

Plani i një kompanie private për ndërtimin e një hidrocentrali në fshatin Vraniç të Komunës së Dragashit është kundërshtuar vazhdimisht nga banorët e këtij fshati. Ky fshat, i banuar kryesisht nga komuniteti goran, ka organizuar disa herë protesta për të ndaluar punimet e kompanisë 'Eurokos JH' për ndërtimin e një mini-hidrocentrali. Madje protesta e fundit e organizuar në korrik 2017 kishte eskaluar në dhunë në mes të protestuesve dhe punëtorëve të kësaj kompanie. Një protestë më e qetë ishte organizuar edhe në tetor 2016. Qytetarët e fshatit Vraniç nuk dëshirojnë që lumi i cili kalon pranë pronave të tyre të shfrytëzohet nga një kompani private.

Prezenca e strukturave paralele serbe

Në Komunën e Dragashit vazhdojnë të jenë prezent strukturat paralele të Serbisë. Përveç mësimet në gjuhën serbe që zhvillohet sipas planprogramit të Qeverisë së Serbisë dhe ekzistimit të administratës paralele serbe në fshatin Vraniç, në këtë komunë Serbia vazhdon të organizojë lirshëm edhe zgjedhje. Në prill të këtij viti, mbi 1,000 goranë kanë votuar për zgjedhjen e Presidentit të Serbisë. Vendvotimi i hapur në fshatin Vraniç ka qenë i mbikëqyrur nga OSBE-ja.

Gjërat që kërkojnë vëmendjen e komunës

Mbyllja e fabrikës 'Rematex'

Në fillim të vitit 2016 ka ndalur së funksionuari fabrika për përpunimin e leshit 'Rematex' në Dragash. Kjo fabrikë kishte pasur mbi 250 punëtorë, kryesisht banorë të Komunës së Dragashit. Pronarët turq të fabrikës kishin ikur duke u mbetur borxh një numri të madh të punëtorëve pagat e tyre të fundit. Sipas ish-punëtorëve, kjo fabrikë përveç borxhit që ka ndaj punëtorëve, ajo ka lënë mbrapa edhe borxhe të mëdha meqë nuk i ka paguar taksat ndaj komunës dhe faturat e ujit. Kjo fabrikë ka filluar së operuari në Komunën e Dragashit në gusht të vitit 2008.

Kapacitetet buxhetore të Dragashit

Buxheti total vjetor i Komunës së Dragashit për vitin 2017 është rreth 7.6 milion euro në vit. Kjo paraqet një rritje të buxhetit në krahasim me vitin 2013 kur ishte vetëm 5.8 milion euro. Përvec planifikimeve të rregullta nga viti 2016 janë bartur rreth 530 mijë euro, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur nga viti paraprak rreth 207 mijë euro.

Në katër vitet e fundit, kategoria e investimeve kapitale ka shënuar rritje nga 1.9 milion euro që ishte më 2013, në 2.6 milion euro më 2017. Kurse kategoria e pagave dhe mëditjeve po ashtu është rritur nga 3.3 milion euro më 2013 në 4.2 milion euro më 2017.



FIGURA NR.1: TRENDET BUXHETORE 2010-2017

Ndërkaq, kategoria e subvencioneve dhe transfereve ka shënuar rënie të madhe, nga 35 mijë euro në 24 mijë euro. Përderisa në vitin 2013, kategoria e subvencioneve përbënte 0.6% të buxhetit të komunës, më 2017 ajo përbën vetëm 0.3% të buxhetit. Sa për krahasim, kategoria e subvencioneve në Komunën e Suharekës përbën 2% të buxhetit, kurse në atë të Prizrenit përbën 1.2% të buxhetit të komunës.




FIGURA NR.2: PËRQINDJA E INVESTIMEVE KAPITALE DHE PAGAVE

Sipas vlerësimeve buxhetore, buxheti vjetor i Komunës së Dragashit nuk pritet të shënojë rritje të madhe as në dy vitet në vijim. Më 2019 parashihet që buxheti total të jetë rreth 7.9 milionë euro.

Në vitin 2016, Komuna e Dragashit ka realizuar të hyra vetanake prej rreth 418 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, të hyrat e kësaj komune janë rritur për rreth 61 mijë euro.




FIGURA NR.3: TË HYRAT VETANAKE 2013-2016

Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të marr këto veprime:

- Të përmirësojë infrastrukturën rrugore duke mënjanuar problemet aktuale dhe duke siguruar cilësi në punimin e rrugëve të reja;
- Të sigurojë kualitetin e ujit të pijshëm në të gjithë fshatrat e komunës;
- Të sigurojë furnizim të plotë me ujë për të gjitha fshatrat;
- Të vë në funksion shkollën e mesme të ndërtuar nga MASHT sa më parë;
- Të zgjidh problemin e banorëve rreth ndërtimit të hidrocentralit të ri;
- Të bëjë përpjekje për inkuadrimin e shkollave që punojnë me planprogramet e Serbisë në planprogramet e Kosovës;
- Të angazhohet që pronarët e fabrikës 'Rematex' t'ua paguajnë punëtorëve pagat e mbetura si dhe vetë komunës borxhet rreth taksave dhe faturave të ujit.



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world